



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:285577

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05762265

P.nr.99/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit A.A nga Vushtrria, për shkak të veprave penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 në lidhje me par.6 dhe në lidhje me par.1 të KPRK-së, si dhe veprës penale Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 374 par.1 të KPRK-së, në bashkim real me veprën nga pika 1 e dispozitivit të aktakuzës në lidhje me nenin 76 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1903/21 e datës 29.12.2021, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 29.05.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorja e Shtetit Vyrtyte Gërvalla, i pandehuri A.A dhe mbrojtësja e tij me autorizim av. Kada Bunjaku Përçuku si dhe i dëmtuari M.P, më dt.29.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 31.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: A.A nga i ati N., e ëma S., e gjinisë J., i lindur më datë ... në komunën e Vushtrrisë, ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, punon herë pas here në ndërtimtari, jeton në bashkësi jashtëmartesore, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë pa i gjykuar, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 06.11.2021 rreth orës 18:05 në rrugën rajonale M. – Vushtrri, në fshatin N., në rrugën dytësore , duke mos iu përmbajtur dispozitave të nenit 71 të Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor, ka rrezikuar trafikun publik dhe me këtë veprim ka rrezikuar jetët e njerëzve edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se me veprimin e vet mund të kryhet vepra, mirëpo ka menduar lehtë se nuk do të ndodh ajo, apo se do të mund ta parandalojë atë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin transportues të tipit VË Kombi, ngjyrë të zezë, me targa ..., në të njëjtin drejtim në të cilin ka lëvizur automjeti i tipit Golf 2, me targa ..., të cilin e drejtonte M.P, nuk ka lejuar tejkalim të sigurt, të cilin automjeti Golf 2 veçse e kishte filluar, por edhe ai ka

ndërmarrë veprimin e tejkalimit, e me atë rast në anën e majtë të automjetit të tij e ka goditur anën e përparme të djathtë të automjetit Golf 2, si pasojë e së cilës, vozitësi i automjetit Golf 2 e ka humbur kontrollin mbi automjetin, automjeti ka dalë nga shiriti qarkullues në anën e djathtë dhe e ka goditur në pjesën e betonit pranë rrugës si pasojë e së cilës është rrotulluar dhe me gjithë këtë vozitësi i automjetit Golf, M.P ka pësuar lëndime në formë të thyerjes së unazave L1 dhe L3 në regjionin e kërdhokullës dhe kurrizit, të cilat paraqesin lëndime të rënda trupore.

- Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 në lidhje me par.6 dhe në lidhje me par.1 të KPRK-së.

SEPSE: Si vozitës i automjetit transportues të tipit VË Kombi, ngjyrë të zezë, me targa ..., me të cilin në rrugën M. – Vushtrri, në fshatin N., në rrugën dytësore, me datën 06.11.2021 rreth orës 18:05 ka shkaktuar aksident në trafik, në të cilin është lënduar M.P, të njëjtit nuk i ka ofruar ndihmë, por pas aksidentit në trafik është larguar nga vendi i ngjarjes,

- Me këtë ka kryer veprën penale Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut public nga neni 374 par.1 të KPRK-së në bashkim real me veprën nga pika 1 e dispozitivit të aktakuzës në lidhje me nenin 76 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe nenit 323 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 322, 364, 462 dhe 449 të KPPK-së, e

## G J Y K O N

Për veprën penale të përshkruar si në pikë I të dispozitivit i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Për veprën penale të përshkruar si në pikën II të dispozitivit i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Me aplikimin e nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit i:

## SHQIPTON

DËNIM UNIK ME BURG në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, me pëlqimin e të pandehurit e konform nenit 44, dënimin me burgim ia zëvendëson me DËNIM ME GJOBË në shumën prej tremijë e pesëqind (3,500) euro.

Ne rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

REFUZOHET propozimi i prokurores së shtetit për shqiptimin e dënimit plotësues marrja e lejes së vozitjes.

Pala e dëmtuar M.P për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm,

### A r s y e t i m

#### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.652/23 e datës 27.05.2023, kundër të pandehurit A.A nga Vushtrria, për shkak të veprave penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 në lidhje me par.6 dhe në lidhje me par.1 të KPRK-së, si dhe veprës penale Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 374 par.1 të KPRK-së, në bashkim real me veprën nga pika 1 e dispozitivit të aktakuzës në lidhje me nenin 76 të KPRK-së,

#### *Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë*

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më dt.29.05.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që:

I pandehuri A.A ka deklaruar se e pranon fajësinë, i vije keq për rastin dhe njëherit i kërkon falje të dëmtuarit për rastin që ka ndodhur dhe i premtton gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të kësaj natyre apo natyrës tjetër. Gjithashtu ka kërkuar nga gjykata që t'i shqiptojë një dënim sa më të butë.

#### *Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë*

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, sa i përket deklarimit të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë i propozojë gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë nga ana e tij, pasi që është në përputhje të plotë me të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës që janë prova të ligjshme të marra nga ana e prokurorit të shtetit. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë në këtë shqyrtim gjyqësor, konsiderojmë se gjendja faktike është vërtetuar si në aktakuzë, andaj gjykatës me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i propozojmë që si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë, keqardhjen e shprehur sot në gjykatë, ndërsa si rrethanë rënduese të merret parasysh sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale, ashtu që i akuzuari edhe pse ka qenë në dijeni për aksidentin e shkaktuar, për lëndimet trupore që i ka pësuar i dëmtuari asnjëherë nuk është interesuar për gjendjen e të dëmtuarit çka tregon se, i njëjti me këto veprime nuk shpreh pendesë për dëmin që ka shkaktuar në aksident. Si rrethanë tjetër rënduese të merret parasysh fakti se i njëjti ka qenë në qarkullim rrugor pa regjistrim dhe sigurim, po ashtu nuk ka poseduar patentë

shofer, të tri këto rrethana meqenëse nuk janë elemente kualifikuese të veprës penale të merren si rrethanë rënduese me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit. Meqenëse i akuzuari në kohën e aksidentit nuk ka poseduar patentë shofer e meqenëse ka kaluar kohë e gjatë nga kryerja e veprës penale, prokurori i shtetit nuk është në dijeni se i njëjti është pajisur me patentë shofer, ashtu që nëse tashmë i njëjti ka patentë shofer, prokurori i shtetit në bazë të nenit 65 të KPRK-së i propozon gjykatës që të njëjtit ti shqiptojë dënim plotësues marrjen e lejes së vozitjes, në bazë të nenit 65 ku ligjvënësi ka paraparë që gjykatë mund t'ia shqiptojë marrjen e lejes së vozitjes kryerësit të veprës penale duke paraparë si kusht esencial që nga aksidenti të jetë shkaktuar lëndim i rëndë trupor.

I dëmtuari deklaron se e pranon pranimin e fajësisë por e njofton gjykatën se i pandehuri asnjëherë nuk ka qenë për të kërkuar falje lidhur me rastin e po ashtu nuk është interesuar për gjendjen time shëndetësore. Njëherit e ka informuar gjykatën se e ka realizuar dëmin nga Byroja Kosovare e Sigurimeve. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, e mbështet fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit,

Av. mbrojtës i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, i mbrojturi im në mënyrë vullnetare bëri pranimin e fajësisë për veprat penale për të cilat ngarkohet dhe i propozojë gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë kurse sa i përket rrethanave do të deklarohej në fjalën përfundimtare. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, duke qenë se i mbrojturi im e pranoi fajësinë për veprat penale për të cilat ngarkohet, gjykatës i propozojë që me rastin e marrjes së vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh këto rrethana; i mbrojturi im përveç që e pranoi fajësinë i kërkojë falje të dëmtuarit, pretoj që nuk do të kryej vepra penale e gjithashtu e njoftoj gjykatën që është e vërtetë se i pandehuri nuk ka shkuar personalisht në shtëpinë e të dëmtuarit por kanë shkuar familjarët e tij, pasi që kanë kuptuar kush është i dëmtuari përmes personave të tjerë. Njëherit i mbrojturi im asnjëherë nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin, në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës së re dhe kjo vepër penale si është përcaktuar është kryer nga pakujdesia, kurse sa i përket pretendimeve të prokurorisë, e kundërshtojë propozimin e prokurores së shtetit për shqiptimin e dënimit plotësues për shkak se nuk janë plotësuar kushtet ligjore, e gjithashtu në kohën e kryerjes e veprës penale i mbrojturi im nuk ka pasur patentë shofer. Gjykatës i propozojë që ti shqiptojë dënim sa më të butë duke qenë se ka rrethana posaçërisht lehtësuese ti shqiptojë dënim me kusht ose me gjobë.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ke deklaruar se, mbetem në tërësi pranë thënieve të avokatit mbrojtës.

#### *Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: Raporti i aksidenti me numër të rastit 2021-BR-722 i datës 06.11.2021, Raporti i oficerit i datës 06.11.2021, Procesverbal i marrjes në pyetje të pandehurit A.A i datës 09.11.2021

në Policinë e Kosovës – Stacioni Policor Mitrovicë – Jug, Procesverbal i marrjes në pyetje i të dëmtuarit M.P i datës 12.11.2021 në Policinë e Kosovës – Stacioni Policor Mitrovicë – Jug, Fletë lëshimi nga Klinika e Prishtinës për M.P i datës 09.11.2021, Mendimin dhe konstatimin e ekspertit të mjekësisë ligjore i datës 22.11.2021, Mendimin dhe konstatimin e ekspertit të trafikut i datës 16.12.2021, foto dokumentacioni dhe shkresat tjera përcjellëse të lëndës.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri nga me dashje ka kryer veprat penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 në lidhje me par.6 dhe në lidhje me par.1 të KPRK-së dhe Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 374 par.1 të KPRK-së, në bashkim real me veprën nga pika 1 e dispozitivit të aktakuzës në lidhje me nenin 76 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 370, par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen: *“Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.”*, ndërsa formë e kualifikuar e kësaj vepre është përcaktuar në par.6 të këtij neni i cili parasheh se: *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.”* dhe par.8: *“Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”*

Në nenin 374 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen: *“Ngasësi i automjetit ose i mjetit tjetër të transportit, i cili nuk i ofron ndihmë personit të lënduar me atë mjet të transportit, dënohet me burgim deri në një (1) vit.”*

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprave penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 në lidhje me par.6 dhe në lidhje me par.1 të KPRK-së dhe Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 374 par.1 të KPRK-së, në bashkim real me veprën nga pika 1 e dispozitivit të aktakuzës në lidhje me nenin 76 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Sa i përket propozimit të prokurorës së shtetit për shqiptimin e dënimit plotësues marrja e lejës së vozitjes, gjykata ka refuzuar këtë propozim për faktin se Marrja e lejës së vozitjes është parapa në dispozitat e KPRK-së përkësisht nenit 65 ku shprehimisht është përcaktuar se, *“Kryesit të veprës penale që e rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t’ia marrë lejen e vozitjes për llojin apo kategorinë e caktuar të automjetit dhe mund t’ia ndalojë kryesit marrjen e lejes së re gjatë periudhës prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Nëse kryesi nuk ka leje të vozitjes, gjykata ia ndalon kryesit marrjen e lejes së vozitjes brenda afatit prej një (1) deri në pesë (5) vjet”*. Në rastin dispozitat e KPRK-së përkatësisht neni 65 nuk ka paraparë situatë të marrjes së patent shoferit, në rast se i pandehuri është pajisur pas kryerjes së veprës penale përkësisht ende pa përfunduar shqyrtimi gjyqësor lidhur me këtë çështje penale.

*Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale si dhe kërkim faljen ndaj të dëmtuarit, ndërsa si rrethana rënduese sa i përket të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e dëmit të shkaktuar tek i dëmtuari për faktin se të njëjti i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore, sjellën e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale si dhe faktin që i njëjti në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë në qarkullim rrugor pa regjistrim dhe sigurim si dhe në të njëjtën kohë nuk ka poseduar patentë shofer.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

*Arsyet lidhur me kërkesën pasurore – juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit.*

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 par. 2 të KPPK-së, ku parashihet se *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi.”*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal  
P.nr.99/23, datë 31.05.2024

GJYQTARI

Numri i lëndës: 2021:285577  
Datë: 31.05.2024  
Numri i dokumentit: 05762265

Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.